



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA"

"Zija Shemsu" p.n., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjiilan.net tel: 0280390112

FORMULARI I VLERËSIMIT F2

Fakulteti	Fakulteti Ekonomik
Lënda/ët për të cilat është shpallur konkursi	Marketingu Digjital; Marketingu Ndërkombëtar; Marketingu i Shërbimeve; Sjellja Konsumatore; Hyrje në Shitje; Projekt; si dhe lëndë të tjera nga fusha e marketingut digjital.
Thirrja për të cilën konkurron kandidati	Profesor i asociuar (Prof. Asoc. Dr.)
Kandidatët e paraqitur:	Prof. Ass. Dr. Lulzim Rashiti

Sqarim nga Komisioni vlerësues:

Komisioni vlerësues është bazuar në konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan, Ref. nr. 01/1446, dt. 21.07.2026, ku për Fakultetin Ekonomik, si pozitë avancimi në thirrjen përkatëse, kërkohet një (1) mësimdhënës për lëndët: Marketingu Digjital; Marketingu Ndërkombëtar; Marketingu i Shërbimeve; Sjellja Konsumatore; Hyrje në Shitje; Projekt; si dhe lëndë të tjera nga fusha e marketingut digjital.

Komisionit i ka arritur një (1) aplikacion, brenda afatit të përcaktuar kohor në konkurs. Aplikimi i kandidatit Prof. Ass. Dr. Lulzim Rashiti është protokolluar me nr. 05-1529, dt. 30.07.2026. Kandidati i plotëson kushtet formalo-juridike për t'u trajtuar dhe është i vetmi aplikant për këtë pozitë.

Komisioni vlerësues është formuar me Vendimin e Këshillit të Fakultetit Ekonomik nr. 548/26, dt. 28.07.2026, marrë në mbledhjen e mbajtur me qarkullim më 27.07.2026.

Komisioni ka shqyrtuar aplikacionin, përkatësisht gjithë dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, në takimin e mbajtur më 14.08.2026. Vlerësimin për kandidatin, duke u bazuar në nenin 171 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan dhe në Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ, Ref. nr. 01/1328, dt. 26.06.2024, Komisioni e paraqet në këtë formular.

Komisioni vlerësues:

Prof. Asoc. Dr. Art Shala, kryetar

Prof. Dr. Nail Reshidi, anëtar

Prof. Asoc. Dr. Lutfi Zharku, anëtar

TË DHËNAT PËR KANDIDATIN

Kandidati 1. Emri dhe mbiemri: LULZIM RASHITI

Tabela 1. Të dhënat për kandidatin për të cilin shkruhet raporti

Emri dhe mbiemri	Lulzim Rashiti	
Ditëlindja dhe vendlindja	07.07.1984, Tërnovc i Madh, Bujanoc	
Grada shkencore dhe viti kur është fituar	Doktor i Marketingut (Dr. sc.), 2022	
Titulli akademik (nëse është rizgjedhje)	Profesor asistent (Prof. Ass. Dr.)	
Viti kur është fituar titulli aktual (nëse është rizgjedhje)	27.10.2022	
Universiteti/fakulteti/departamenti ku është fituar titulli akademik	Universiteti Publik “Kadri Zeka”, Gjilan, Fakulteti Ekonomik	
ARSIMIMI I LARTË		
STUDIMET THEMELORE	Institucioni	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Ekonomik
	Vendi	Prishtinë, Republika e Kosovës
	Titulli i fituar	Bachelor në Marketing (BSc)
	Data / viti i diplomimit	17.07.2009
	Fusha e studimit	Marketing
STUDIMET MASTER / MAGJISTRATURË	Institucioni	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Ekonomik
	Vendi	Prishtinë, Republika e Kosovës
	Titulli i fituar	Master i shkencave ekonomike, Marketing (MSc)
	Data / viti i diplomimit	21.06.2012
	Fusha e studimit	Marketing
STUDIMET E DOKTORATËS	Institucioni	University of National and World Economy, Fakulteti i Menaxhimit dhe Administrimit
	Vendi	Sofje, Republika e Bullgarisë
	Titulli i fituar	Doktor i Marketingut (Dr. sc.)
	Data / viti i diplomimit	27.05.2022
	Fusha e studimit	Marketing

Tabela 2. Të dhënat lidhur me gradën e fituar shkencore

Grada shkencore	Doktor i Marketingut (Dr. sc.)
Thirrja e fituar akademike	Profesor asistent (Prof. Ass. Dr.)
Viti kur është fituar thirrja aktuale (vlen për rizgjedhje)	27.10.2022
Vendimi nr.	Vendim i Senatit të UKZ-së nr. 01/2101, dt. 27.10.2022 (mbledhja e mbajtur më 03.10.2022). Kontrata e punës Ref. nr. 01/2162, dt. 27.10.2022, me kohëzgjatje 01.10.2022 deri 30.09.2026.
Universiteti / Fakulteti / Departamenti	University of National and World Economy, Sofje, Bullgari, Fakulteti i Menaxhimit dhe Administrimit
Nostrifikimi / MASHT / NARIC	Vendim i Këshillit Shtetëror për Njohje, MASHTI, Ref. nr. 2/6-2260, dt. 23.06.2022

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 2

Kandidati Lulzim Rashiti ka gradën shkencore Doktor i Marketingut, të fituar më 27.05.2022 në University of National and World Economy në Sofje, Republika e Bullgarisë, me disertacionin “Marketingu digjital në bankingu me pakicë: krijimi dhe shpërndarja e vlerës së klientit”. Grada është njohur në Republikën e Kosovës me vendimin e Këshillit Shtetëror për Njohje pranë MASHTI-t, Ref. nr. 2/6-2260, dt. 23.06.2022, si gradë shkencore e nivelit të tetë sipas KKK-së dhe KEK-së.

Thirrjen akademike Profesor asistent kandidati e ka fituar me vendimin e Senatit të UKZ-së nr. 01/2101, dt. 27.10.2022, për një periudhë katërvjeçare, të konkretizuar me kontratën e punës Ref. nr. 01/2162 për

periudhën 01.10.2022 deri 30.09.2026. Me këtë kandidati i plotëson kushtet formalo-juridike sipas nenit 171 të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan dhe nenit 6, paragrafi 2, pika 2.1 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ, Ref. nr. 01/1328, dt. 26.06.2024.

Komisioni thekson se të tri nivelet e studimeve, bachelor, master dhe doktoratë, kandidati i ka të përfunduara në fushën e marketingut, ndërsa tema e masterit dhe ajo e doktoratës i takojnë fushës së ngushtë të marketingut elektronik, përkatësisht digjital. Me këtë plotësohet edhe kërkesa e nenit 10, paragrafi 12 të Rregullores, sipas së cilës për titullin e profesorit vlerësohet përputhja e fushës së ngushtë së paku në nivelin master dhe të doktoratës me lëndët e konkursit.

Tabela 3. Monografi

Nr.	Autori/ët	Titulli i publikimit	Fusha studimore	Recensentët	Shtëpia botuese, vendi, viti
1.	Lulzim Rashiti	Marketingu digjital në bankë me pakicë: krijimi dhe shpërndarja e vlerës së klientit (monografi)	Marketing digjital	Prof. Dr. Gjokë Uldedaj Prof. Dr. Xhevat Sopi	“Lena”, Prishtinë, 2025, 248 f. ISBN 978-9951-32-294-2 Katalogimi CIP, Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”. Botimi miratuar me vendimin e Këshillit të Fakultetit Ekonomik, ref. 241, dt. 10.10.2025

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 3

Kandidati ka të botuar një monografi me titull “Marketingu digjital në bankë me pakicë: krijimi dhe shpërndarja e vlerës së klientit”, botuar nga shtëpia botuese “Lena” në Prishtinë në vitin 2025, me 248 faqe, me ISBN 978-9951-32-294-2 dhe të katalogur në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”. Botimi i saj është miratuar me vendimin e Këshillit të Fakultetit Ekonomik të UKZ-së, ref. 241, dt. 10.10.2025, dhe monografia është recensuar nga dy recensentë me gradën Dr. sc. në fushën e njëjtë.

Përveç kësaj, sipas nenit 10, paragrafi 1 të Rregullores, monografi konsiderohet edhe një tezë e mbrojtur e doktoratës, prandaj disertacioni i kandidatit i mbrojtur më 27.05.2022 në UNWE Sofje i njihet gjithashtu si monografi.

Përmbajtja e monografisë i takon plotësisht fushës së marketingut digjital dhe është në përputhje të drejtpërdrejtë me lëndët e shpallura në konkurs. Me këtë kandidati i plotëson kushtet formalo-juridike sipas nenit 171 të Statutit të UKZ-së dhe nenit 6, paragrafi 2, pika 2.3 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ, Ref. nr. 01/1328, dt. 26.06.2024.

Tabela 4. Tekstet mësimore

Nr.	Autori/ët	Titulli i publikimit	Fusha studimore	Recensentët	Shtëpia botuese, vendi, viti
1.					

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 4

Kandidati nuk ka paraqitur tekste mësimore universitare. Komisioni thekson se teksti mësimor nuk përbën kusht për fitimin e titullit akademik “Profesor i asociuar” sipas nenit 6 të Rregullores, por kërkohet vetëm për titullin “Profesor i rregullt”, sipas nenit 5, paragrafi 2, pika 2.4 të saj.

Tabela 5. Punimet e publikuara në revistat ndërkombëtare shkencore, sipas UA – MASHT nr. 01/2018 dhe nenit 6, pika 2.4 dhe nenit 10, pika 4 të Rregullores, Ref. nr. 01/1328, dt. 26.06.2024, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1.	Rashiti, L., Jashari, Sh., Katrandzhiev, H. I. (2025)	The Impact of Promotional Activities on Consumer Behavior: A Case Study of the Beverage Industry in Kosovo	Economic Studies (Ikonomicheski Izsledvania), Instituti i Kërkimeve Ekonomike pranë Akademisë Bullgare të Shkencave	Vol. 34, nr. 6, fq. 125-140, 2025	https://econ-studies.iki.bas.bg/ Punim i indeksuar në SCOPUS

2.	Rashiti, L., Shala, A., Sopi, Xh. (2023)	Digital Marketing in Retail Banking: Analysis of Managers' Attitudes	Business Management, D. A. Tsenov Academy of Economics, Svishtov DOI: 10.58861/tac.bm.2023.2.02	Year XXXIII, Book 2, fq. 23-46, 2023	https://bm.uni-svishtov.bg/title.asp?title=2844 Punim i indeksuar në SCOPUS
3.	Rashiti, L., Sopi, Xh. (2022)	Digital Marketing in Retail Banking: Client Attitudes Analysis	Economic Alternatives, University of National and World Economy, Sofje DOI: 10.37075/EA.2022.3.06	Nr. 3, fq. 454-472, 2022	https://doi.org/10.37075/EA.2022.3.06 Punim i indeksuar në SCOPUS

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 5

Kandidati Lulzim Rashiti ka të publikuara tri (3) punime kryesore në revista shkencore ndërkombëtare, të gjitha të indeksuara në platformën Scopus (Elsevier), përkatësisht në databizat e përcaktuara me nenin 10, paragrafi 4, pika 1.2 të Rregullores dhe me Udhëzimin Administrativ të MASHT-it nr. 01/2018. Në të tria punimet kandidati figuron si autor i parë, në pajtim me nenin 10, paragrafi 3 të Rregullores.

Verifikimi i punimeve është bërë përmes linkave identifikues të paraqitur në tabelë dhe përmes kopjeve fizike të punimeve të bashkëngjitura në dosjen e aplikimit. Komisioni konstaton se asnjëra nga revistat përkatëse nuk figuron në lista të revistave ose botuesve të dyshimtë, në kuptimin e nenit 10, paragrafi 5 të Rregullores.

Nga tri punimet, dy (2) janë publikuar pas fitimit të thirrjes së fundit akademike, përkatësisht punimi në revistën “Business Management” të Akademisë “D. A. Tsenov” në Svishtov në vitin 2023 dhe punimi në revistën “Economic Studies” të Akademisë Bullgare të Shkencave në vitin 2025. Punimi i tretë, në revistën “Economic Alternatives” të UNWE-së, është publikuar në vitin 2022 dhe është marrë parasysh me rastin e fitimit të thirrjes akademike Profesor asistent.

Të tria punimet i takojnë fushës së ngushtë të marketingut digjital dhe të sjelljes konsumatore, pra pikërisht fushës për të cilën është shpallur konkursi, në pajtim me nenin 10, paragrafi 12 të Rregullores.

Me këto publikime kandidati i plotëson kushtet formalo-juridike sipas nenit 171 të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan dhe nenit 6, paragrafi 2, pika 2.4 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ, Ref. nr. 01/1328, dt. 26.06.2024, me të cilin kërkohen së paku tri (3) punime kryesore të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare, nga të cilat dy (2) pas fitimit të thirrjes së fundit akademike.

Tabela 6. Punimet e publikuara në revista rajonale (Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia, B e H)

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues
1.	Kalas, B., Stameski, N., Drec, L., Rashiti, L. (2017)	Taxation Trends in United Kingdom	International Journal of Applied Economic Studies ISSN: 2345-5721	Vol. 5, Issue 1, shkurt 2017	http://sijournals.com/IJAE/
2.	Rashiti, L., Pjanić, M. (2017)	Corporate Governance in the Serbian Banking Industry: Case Studies: Commercial Bank, Halk Bank, Erste Bank	Journal of Advanced Scientific Research and Innovation (JASRI) ISSN: 219 318 11	Vol. 11, nr. 31, qershor 2017	www.journalos.com
3.	Rashiti, L., Zylfiu, V. (2016)	Mergers and Acquisitions in Banking Sector: The Case of Western Balkan Countries / BKT Albania	Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences (AJBALS) E-ISSN 2411-9725 / ISSN 2410-759X	Nëntor 2016, Tiranë, Shqipëri	http://iipcccl.org/
4.	Rashiti, L., Kalas, B., Drec, L., Stameski, N. (2016)	Credit Risk Management: Loan Approval Process	Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences (AJBALS), IIPCCCL Publishing ISSN 2410-3918	Vol. 2, nr. 1, mars 2016, Tiranë, Shqipëri	https://iipcccl.org/

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 6

Kandidati ka të botuara katër (4) punime në revista shkencore jashtë territorit të Republikës së Kosovës, në rajon, nga të cilat në dy (2) figuron si autor i parë. Këto publikime nuk janë kusht i veçantë për fitimin e

titullit “Profesor i asociuar”, por dëshmojnë vazhdimësinë e angazhimit kërkimor shkencor të kandidatit në një periudhë disaveqare.

Tabela 7. Punimet e publikuara në revista kosovare

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku
1.	Rashiti, L., Sopi, Xh. (2015)	Aplikimi i strategjive të e-marketingut nga bankat komerciale në Kosovë: sfidat dhe mundësitë	REFORMA, Instituti për Studime Ligjore dhe Demokratike	Nr. 086/15, shtator 2015, fq. 65, Gjilan	www.isld-ks.com

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 7

Kandidati ka të botuar një (1) punim në një revistë shkencore vendore, në fushën e marketingut elektronik në sektorin bankar, si autor i parë.

Tabela 8. Prezantimet në konferenca

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi etj.	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku
1.	Jashari, Sh., Rashiti, L. (2026)	Ndikimi i marketingut digjital në tregtinë me pakicë në angazhimin e konsumatorëve në sektorin e tregtisë me pakicë në Kosovë	Konferenca Shkencore Ndërkombëtare Vjetore UKZ AC 2026, “Ndikimi i Shkencës në Zhvillimin e Qëndrueshëm”, Universiteti Publik “Kadri Zeka”, Gjilan	29-30 maj 2026	Certifikatë prezantimi, dëshmi në dosje
2.	Jashari, Sh., Rashiti, L. (2025)	Marketingu në kompanitë e mëdha kosovare: shpenzim apo investim?	Konferenca Shkencore Ndërkombëtare Vjetore UKZ AC 2025, Sesioni i Ekonomisë, “Teknologjia, Shkenca dhe Arsimi: Rugët drejt një Shoqërie Inteligjente”, UKZ, Gjilan	02 qershor 2025	Certifikatë prezantimi, dëshmi në dosje
3.	Rashiti, L., Shkodra, N. (2025)	Marketingu digjital dhe efekti i rrjeteve sociale në bizneset kosovare	Konferenca Ndërkombëtare Shkencore ISCOIM 2025, “Mundësitë dhe Sfidat e Marketingut në Epokën e Inteligjencës Artificiale”, Departamenti i Marketingut, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Shqipëri	11-12 prill 2025	Certifikatë prezantimi, dëshmi në dosje
4.	Miftari, B., Rashiti, L. (2024)	Analizë e preferencave ndaj markave të vajit ushqimor dhe procesit të vendimmarrjes së konsumatorit në Gjilan, Kosovë: rast studimi, Kompania Fluidi Group (Floil)	Konferenca Shkencore Ndërkombëtare Vjetore UKZ AC 2024, “Trendet dhe Sfidat në Zhvillimin e Shoqërisë Bashkëkohore”, UKZ, Gjilan	2024	Certifikatë prezantimi, dëshmi në dosje
5.	Jashari, Sh., Rashiti, L. (2024)	Konsumatori digjital dhe rëndësia e tij në mediat sociale: rast studimi, marka RC Cola	Konferenca e 3-të Ndërkombëtare për Shkenat Sociale dhe Shëndetësore, UNI Universum International College, Kampusi i Prishtinës	04 dhjetor 2024	Certifikatë prezantimi, dëshmi në dosje
6.	Rashiti, L., Zjenuallahu, F. (2023)	Roli i diplomacisë në funksion të zhvillimit ekonomik: Anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe në Bankën Botërore	Konferenca Shkencore Ndërkombëtare Vjetore UKZ AC 2023, “Shkenca dhe Teknologjia në Promovimin e Jetës Njerëzore”, UKZ, Gjilan	01-02 qershor 2023	Certifikatë prezantimi, dëshmi në dosje
7.	Rashiti, L., Prendi, M. (2022)	Roli i Marketingut Digjital dhe Transformimit Digjital në Sektorin Bankar	Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Strategic Planning and Marketing in Digital World”, Departamenti i Marketingut dhe Planifikimit Strategjik, University of National and World Economy, Sofje, Bullgari	11 nëntor 2022	www.msp-conference.u nwe.bg/en
8.	Rashiti, L., Shkodra, N. (2019)	Politika monetare: Zhvillimi i politikave monetare në periudhën mes viteve 2000 dhe 2017, rast studimi: krahasim mes Serbisë dhe Shqipërisë	Konferenca e XI-të shkencore ndërkombëtare dhe Konferenca e III-të shkencore ndërkufitare, Instituti për Hulumtime Shkencore dhe Zhvillim, Ulqin, Mali i Zi	05 prill 2019	www.ekono mskiinstitut. com

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 8

Kandidati Lulzim Rashiti ka paraqitur pjesëmarrjen e tij aktive me punime në tetë (8) konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, të mbajtura në Kosovë, Shqipëri, Bullgari dhe Mal të Zi.

Nga këto, shtatë (7) janë realizuar pas fitimit të thirrjes akademike Profesor asistent më 27.10.2022, ndërsa gjashtë (6) prej tyre janë dëshmuar me certifikata prezantimi të bashkëngjitura në dosjen e aplikimit, në pajtim me formën e kërkuar me nenin 6, paragrafi 2, pika 2.5 të Rregullores. Pjesa dërrmuese e punimeve të prezantuara i takon fushës së marketingut digjital dhe të sjelljes konsumatore.

Me këtë kandidati i plotëson kushtet formalo-juridike sipas nenit 171 të Statutit të UKZ-së dhe nenit 6, paragrafi 2, pika 2.5 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ, Ref. nr. 01/1328, dt. 26.06.2024, me të cilin kërkohen së paku tri (3) pjesëmarrje aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, nga të cilat dy (2) pas thirrjes së fundit akademike.

Tabela 9. Kontribute të tjera shkencore dhe profesionale

Nr.	Autorët (renditja si në kontributin shkencor)	Lloji i kontributit shkencor	Vendi, viti
1.	Lulzim Rashiti	Prodekan i Fakultetit Ekonomik të Universitetit Publik “Kadri Zeka”	Gjilan, nga 19.01.2024
2.	Lulzim Rashiti	Koordinator për praktika dhe biznese, Universiteti Publik “Kadri Zeka”, Ref. nr. 01/2636, dt. 09.12.2019	Gjilan, nga 2019
3.	Lulzim Rashiti	Anëtar i grupit punues për hartimin e Raportit të Vetëvlerësimit për akreditim të Fakultetit Ekonomik	Gjilan, 2019
4.	Lulzim Rashiti	Mentor dhe anëtar i komisioneve për mbrojtjen publike të temave të masterit, programi master “E-Qeverisja”, UKZ	Gjilan, 2024-2026
5.	Lulzim Rashiti	Ekspert financiar i licencuar, ekspertiza financiare në gjykatat e Republikës së Kosovës, certifikatë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës	Kosovë, nga 2018
6.	Lulzim Rashiti	Konsulent profesional i angazhuar për bizneset e Luginës së Preshevës, Unioni i Bizneseve Shqiptare, Bujanoc, dhe Oda Ekonomike e Serbisë, zyra në Bujanoc	2018 dhe 2019, vazhdon
7.	Lulzim Rashiti	Trajnim “Using the Anti-Plagiarism System, Google Classroom”, Universiteti Publik “Kadri Zeka”	Gjilan, 03.03.2025
8.	Lulzim Rashiti	Trajnim për menaxhim, HERAS Plus, Higher Education, Research and Applied Science	2022
9.	Lulzim Rashiti	European Foundation Certificate in Banking (EFCB), European Banking and Financial Services Training Association	2014
10.	Lulzim Rashiti	Certifikatë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, BM Consulting	2012

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 9

Nga të dhënat e paraqitura më sipër shihet se kandidati jep një kontribut të vazhdueshëm dhe të çmuar në jetën institucionale të Universitetit Publik “Kadri Zeka”. Angazhimi i tij si Prodekan i Fakultetit Ekonomik nga 19.01.2024, si Koordinator për praktika dhe biznese nga viti 2019, si anëtar i grupit punues për hartimin e Raportit të Vetëvlerësimit për akreditim, si dhe si mentor dhe anëtar i komisioneve për mbrojtjen e temave të masterit, dëshmojnë aftësinë e tij për udhëheqje akademike në kuptimin e nenit 10, paragrafi 9 të Rregullores.

Kontributi i tij në lidhjen e universitetit me industrinë dhe tregun e punës, si dhe angazhimi si ekspert financiar i licencuar dhe si konsulent profesional për bizneset, dëshmojnë njohuri dhe mjeshtri të aplikuar në fushën përkatëse, në kuptimin e nenit 6, paragrafi 2, pika 2.7 të Rregullores.

Tabela 10. Përvoja në mësimdhënie universitare

Periudha e angazhimit (vitet akademike)	Grada shkencore dhe Thirrja akademike	Institucioni, Vendi	Programi i studimit	Ligjërues i lëndëve	Vërejtje
2022/2023 – 2025/2026 (vazhdon)	Dr. sc. Profesor asistent	Universiteti Publik “Kadri Zeka”, Gjilan, Fakulteti Ekonomik	Marketing; Menaxhim i Shitjes me Pakicë	Marketingu Digjital (Marketingu elektronik), Marketingu Ndërkombëtar, Marketingu i Shërbimeve, Sjellje Konsumatore, Hyrje në Shitje, Menaxhimi i Shitjes, Projekt	Ligjërata

2021/2022	Kandidat i doktoratës Profesor i angazhuar	Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë dhe Kampusi në Shkup, Republika e Maqedonisë Veriperëndimore	Diplomaci	Ekonomia Globale, Biznes Ndërkombëtar, Politika Ekonomike Ndërkombëtare	Ligjërata
2014/2015 – 2021/2022	Kandidat i doktoratës Asistent i rregullt	Universiteti Publik “Kadri Zeka”, Gjilan, Fakulteti Ekonomik	Banka, Financa dhe Kontabilitet; Menaxhment dhe Ndërmarrësi; Marketing; Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar	Bazat e Marketingut, Marketingu i Shërbimeve, Marketingu Ndërkombëtar, Kërkime Marketingu, Sjellje Konsumatore, Biznes Ndërkombëtar, Ekonomia e Kosovës dhe e BE-së, Mikroekonomi, Makroekonomi, Bankat dhe Afarizmi Bankar	Ushtrime
2015/2016	Kandidat i doktoratës Asistent i angazhuar	Universiteti i Novi Sadit, Fakulteti Ekonomik i Suboticës, dega në Bujanoc	Ekonomi	Bankat dhe Afarizmi Bankar	Ushtrime
2011/2012 – 2013/2014	Asistent i angazhuar	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Ekonomik, njësia në Gjilan	Ekonomiks; Marketing; Banka, Financa dhe Kontabilitet; Menaxhment dhe Informatikë	Marketing, Biznes Ndërkombëtar, Ekonomia e Kosovës dhe e BE-së	Ushtrime

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 10

Kandidati Lulzim Rashiti ka një përvojë të pandërprerë në mësimdhënie universitare që nga viti akademik 2011/2012, pra mbi katërmëdhjetë vjet. Punën akademike e ka nisur si asistent i angazhuar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, njësia në Gjilan, ka vazhduar si asistent i rregullt në Fakultetin Ekonomik të UKZ-së nga viti 2014, ndërsa nga 01.10.2022, në cilësinë e Profesorit asistent, mban ligjërata në Fakultetin Ekonomik të UKZ-së.

Lëndët të cilat kandidati i ka mbajtur dhe i mban aktualisht në UKZ, konkretisht Marketingu Digjital, Marketingu Ndërkombëtar, Marketingu i Shërbimeve, Sjellje Konsumatore, Hyrje në Shitje, Menaxhimi i Shitjes dhe Projekt, përputhen plotësisht me lëndët e shpallura në konkursin Ref. nr. 01/1446, dt. 21.07.2026. Përvoja e tij është dëshmuar me vendimin e emërimit dhe me kontratën valide të punës, të bashkëngjitura në dosje.

Po kështu, sipas Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi të UKZ-së, kandidati ka treguar performancë të shkëlqyer në mësimdhënie gjatë kohës sa ka qenë i angazhuar në Fakultetin Ekonomik të UKZ-së. Vlerësimi i aftësisë për mësimdhënie është bërë në këtë mënyrë, në pajtim me nenin 10, paragrafi 7 dhe nenin 15, paragrafi 4, pika 4.2 të Rregullores, meqenëse kandidati ka themeluar marrëdhënie pune më herët dhe, rrjedhimisht, nuk i nënshtrohet ligjëratës provuese, e cila sipas nenit 15, paragrafi 4, pika 4.1 paraqitet vetëm me rastin e pranimit për herë të parë në punë në UKZ.

Prandaj kandidati Lulzim Rashiti i plotëson kushtet sipas nenit 171 të Statutit të UKZ-së, si dhe nenit 6, paragrafi 2, pikat 2.6 dhe 2.7 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ, Ref. nr. 01/1328, dt. 26.06.2024.

Tabela 11. Udhëheqje të temave master dhe të doktoratës

Periudha e mentorimit	Institucioni, Vendi	Mentorime në studimet Master	Mentorime në studimet e doktoratës	Vërejtje
2025-2026	Universiteti Publik “Kadri Zeka”, Gjilan, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, programi master “E-Qeverisja”	Gentrit Azemi: “Sistemi buxhetor në Republikën e Kosovës me studim të veçantë në Komunën e Gjilanit për vitin 2020-2023”	//	Mentor
2025-2026	Universiteti Publik “Kadri Zeka”, Gjilan, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, programi master “E-Qeverisja”	Donjetë Morina: “Implementimi i e-qeverisjes në institucionet publike, rast studimi Komuna e Gjilanit”	//	Mentor
2024-2026	Universiteti Publik “Kadri Zeka”, Gjilan, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, programi master “E-Qeverisja”	Shërifë Mehmeti: “Ndikimi i shitjes online në biznese të vogla dhe të mesme në Kosovë”	//	Mentor

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 11

Kandidati ka udhëhequr si mentor tri (3) tema të nivelit master në programin master “E-Qeverisja” të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan. Dëshmitë përkatëse, përkatësisht vendimet e Këshillit të programit master, janë bashkëngjitur në dosjen e aplikimit.

Me këtë kandidati i plotëson kushtet formalo-juridike sipas nenit 171 të Statutit të UKZ-së dhe nenit 6, paragrafi 2, pika 2.2 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ, Ref. nr. 01/1328, dt. 26.06.2024, me të cilin kërkohet udhëheqja me sukses e së paku një (1) teme master.

Tabela 12. Pjesëmarrja e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme

Nr.	Programi / projekti shkencor	Periudha kohore	Institucioni, vendi	Pozita në program, projekt / Kontribut
1.	Staff Mobility (Erasmus+)	2025	Kastamonu University, Turqi	Staf shkëmbimi
2.	SMAHPC, Student-Run Multidisciplinary Allied Health Practice Center	2023-2024	Helsinki, Finlandë	Pjesëmarrës, vizitë studimore dhe zhvillim e zbatim i trajnimit
3.	Staff Mobility (Erasmus+)	2022	University of Jaén, Spanjë	Staf shkëmbimi
4.	ResearchCult, Enhancing Research in Higher Education in Kosovo	2021	Sapienza University of Rome, Itali	Vizitë studimore dhe trajnim i stafit
5.	EUFORIA, Entrepreneurial Universities for Industry Alliances	2016-2017	Staffordshire University, Mbretëria e Bashkuar	Placement Officer, zyrtar i karrierës dhe koordinim me bizneset

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 12

Nga tabela 12 evidentohet se kandidati ka pasur një angazhim të vazhdueshëm në programe dhe projekte të bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe në realizimin e disa periudhave të mobilitetit akademik në universitete evropiane dhe në Turqi. Ky angazhim dëshmon se kandidati është në rrjedhë të zhvillimeve aktuale në fushën e arsimit të lartë në Zonën Evropiane dhe përmbush kërkesat e nenit 10, paragrafi 8 të Rregullores lidhur me pjesëmarrjen në projekte dhe grupe punuese.

PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

(THIRRJA AKADEMIKE E CILA PROPOZOHEJ) Profesor i asociuar (Prof. Asoc. Dr.)

Komisioni vlerësues, i formuar me Vendimin e Këshillit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan, nr. 548/26, dt. 28.07.2026, duke u bazuar në nenin 171 të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjiilan, në Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ, Ref. nr. 01/1328, dt. 26.06.2024, si dhe në konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjiilan, Ref. nr. 01/1446, dt. 21.07.2026, pas shqyrtimit të dosjes së kandidatit dhe pas vlerësimit të performancës në mësimdhënie nga Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi e UKZ-së, për pozitën një (1) mësimdhënës për lëndët: Marketingu Digjital; Marketingu Ndërkombëtar; Marketingu i Shërbimeve; Sjellja Konsumatore; Hyrje në Shitje; Projekt; si dhe lëndë të tjera nga fusha e marketingut digjital,

PROPOZON

Prof. Ass. Dr. Lulzim Rashiti për thirrjen akademike Profesor i asociuar (Prof. Asoc. Dr.) në Fakultetin Ekonomik të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan.

ARSYETIM

Komisioni erdhi deri te ky propozim pas shqyrtimit dhe analizimit të detajuar të dëshmive të ofruara në dosjen e kandidatit të vetëm që ka aplikuar për këtë pozitë, ku u konstatua se kandidati Prof. Ass. Dr. Lulzim Rashiti i plotëson të gjitha kushtet e parapara në Statutin e UKZ-së, në Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ, si dhe në konkursin e shpallur. Komisioni vlerësues, njëzëri, propozon që kandidati Prof. Ass. Dr. Lulzim Rashiti të zgjedhet në thirrjen akademike Profesor i asociuar (Prof. Asoc. Dr.) për lëndët e shpallura në konkurs.

Këtë propozim, Komisioni vlerësues bazuar në:

1. Kandidati Lulzim Rashiti ka gradën shkencore Doktor i Marketingut, të fituar më 27.05.2022 në University of National and World Economy në Sofje dhe të nostrifikuar me vendimin e MASHTI-t Ref. nr. 2/6-2260, dt. 23.06.2022, si dhe thirrjen akademike Profesor asistent, të fituar me vendimin e Senatit të UKZ-së nr. 01/2101, dt. 27.10.2022. Me këtë i plotëson kushtin e nenit 6, paragrafi 2, pika 2.1 të Rregullores. Të tri nivelet e studimeve i ka në fushën e marketingut, ndërsa tema e masterit dhe e doktoratës i takojnë fushës së ngushtë të marketingut digjital, në përputhje me nenin 10, paragrafi 12 të Rregullores.
2. Kandidati ka udhëhequr si mentor tri (3) tema të nivelit master në programin master “E-Qeverisja” të UKZ-së, me çka e tejkalon kushtin e nenit 6, paragrafi 2, pika 2.2 të Rregullores, i cili kërkon udhëheqjen me sukses të së paku një (1) teme master.
3. Kandidati ka të botuar një monografi nga fusha e marketingut digjital, “Marketingu digjital në bankë me pakicë: krijimi dhe shpërndarja e vlerës së klientit”, Prishtinë, 2025, ISBN 978-9951-32-294-2, e recensuar nga dy recensentë me gradën Dr. sc. dhe e miratuar për botim me vendimin e Këshillit të Fakultetit Ekonomik ref. 241, dt. 10.10.2025. Gjithashtu, sipas nenit 10, paragrafi 1 të Rregullores, edhe disertacioni i doktoratës i njihet si monografi. Me këtë i plotëson kushtin e nenit 6, paragrafi 2, pika 2.3 të Rregullores.
4. Kandidati ka të publikuara tri (3) punime kryesore në revista shkencore ndërkombëtare, të gjitha të indeksuara në platformën Scopus (Elsevier) dhe në të gjitha si autor i parë, nga të cilat dy (2) janë publikuar pas fitimit të thirrjes së fundit akademike, konkretisht në vitet 2023 dhe 2025. Me këtë i plotëson kushtin e nenit 6, paragrafi 2, pika 2.4 të Rregullores, si dhe kërkesat e Udhëzimit

Administrativ të MASHT-it nr. 01/2018. Punimet i takojnë fushës së ngushtë të marketingut digjital dhe të sjelljes konsumatore.

5. Kandidati ka marrë pjesë aktive me punime në tetë (8) konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, nga të cilat shtatë (7) pas fitimit të thirrjes së fundit akademike dhe gjashtë (6) të dëshmuara me certifikata prezantimi. Me këtë i plotëson kushtin e nenit 6, paragrafi 2, pika 2.5 të Rregullores.
6. Kandidati ka një përvojë të pandërprerë prej mbi katërmëdhjetë vjetësh në mësimdhënie universitare, prej së cilës nga 01.10.2022 si Profesor asistent në Fakultetin Ekonomik të UKZ-së, ku ligjëron pikërisht lëndët e shpallura në konkurs. Sipas Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi të UKZ-së, kandidati ka treguar performancë të shkëlqyer në mësimdhënie. Me këtë i plotëson kushtet e nenit 6, paragrafi 2, pikat 2.6 dhe 2.7 të Rregullores.
7. Kandidati dëshmon punë, dije dhe mjeshtri në lëndët e fushës përkatëse edhe përmes kontributeve institucionale dhe profesionale, si Prodekan i Fakultetit Ekonomik nga 19.01.2024, si Koordinator për praktika dhe biznese nga viti 2019, si anëtar i grupit punues për hartimin e Raportit të Vetëvlerësimit për akreditim, si ekspert financiar i licencuar dhe si konsulent profesional për bizneset, si dhe përmes pjesëmarrjes në pesë (5) programe dhe projekte ndërkombëtare të mobilitetit dhe bashkëpunimit akademik.

Duke marrë parasysh të gjitha sa më sipër, Komisioni vlerësues konstaton se kandidati Prof. Ass. Dr. Lulzim Rashiti i plotëson në tërësi kushtet e parapara me nenin 171 të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjilan, me nenin 6 të Rregullores Ref. nr. 01/1328, dt. 26.06.2024, si dhe me konkursin Ref. nr. 01/1446, dt. 21.07.2026, dhe njëzëri propozon zgjedhjen e tij në thirrjen akademike Profesor i asociuar (Prof. Asoc. Dr.).

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:

Prof. Asoc. Dr. Art Shala, kryetar



Prof. Dr. Nail Reshidi, anëtar



Prof. Asoc. Dr. Lutfi Zharku, anëtar



Gjilan, më 17 gusht 2026